



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 308 Prot.

Tiranë, më 01.03.2018

VENDIM Nr. 28, datë 21.02.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 30, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.2, datë 21.02.2018, pasi shqyrtoi Informacionin mbi potencialin arkeologjik të zonës ku do të zhvillohet projekti "*Godinë banimi dhe shërbimesh 9 kate me dy kat nëntokë*", rruga "*Hysen Kërtusha*", zonë arkeologjike "*B*" Durrës-subjekti "TOP CONSTRUCTION" sh.p.k. dhe Konceptin e sondazheve arkeologjike, të paraqitur paraprakisht nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama,

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin e sondazheve arkeologjike, të paraqitur paraprakisht nga individ i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama, me kushtin e reduktimit të tyre, në pesë sondazhe gjithsej, me dimensione 4 x 6m. Koncepti me numrin e reduktuar të sondazheve të depozitohet pranë ASHA.
2. Subjekti "TOP CONSTRUCTION" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO